

Shënim në lidhje me plotësimin e këtij akti administrativ:

- Grupi i Monitorimit do të pasqyrojë prezencën në punë të nëpunësve civilë si dhe lëvizjet e tyre gjatë orarit zyrtar, sipas kësaj tabele.
- Në mënyrë narrative, njësia përgjegjëse do të pasqyrojë në këtë akt edhe rastet e emërmeve të reja, duke specifikuar edhe procedurën e realizimit të tyre, si edhe rastet e largimeve apo lirimeve nga puna, duke bashkëlidhur edhe kopje të akteve administrative dhe praktikave përkatëse.
- Frekuenca e kontrolleve që do të kryhen çdo ditë gjatë orarit zyrtar të punës, do të çmohet nga Grupi i Monitorimit.
- Në rastet kur konstatohen shkelje të ligjit, Grupi i Monitorimit do të mbajë procesverbal.
- Në rastet e mungesave të arsyeshme, dokumenti justifikues do t'i bashkëlidhet listëprezencës ditore.
- Dokumentacioni i hartuar nga Grupi i Monitorimit (*listëprezencat, procesverbalet si dhe çdo dokument tjetër*) duhet të jenë të nënshkruara nga Grupi i Monitorimit.